



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 19.6.2020

**Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 19.6.2020, para Trupit Gjygues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

**Të nderuar anëtarë të Trupit Gjygues,**

Sikurse pasqyrohet në procesverbalin e datës 19.2.2020 të Trupit Gjygues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Trupi Gjygues, në bazë të nenit “F/3”, të aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur:

- Të çelë hetimin për të verifikuar marrëdhënien që ka pasur i ati i subjektit të rivlerësimit, z. \*\*\*.\*\*, lidhur me pronën e ndodhur në Tiranë në rrugën “\*\*\*.\*\*”, me sipërfaqe 141.87 m<sup>2</sup>, duke iu drejtuar me informacion dhe aktet bashkëlidhur:
  - i. Për kontratën e furnizimit me ujë të apartamentit me numër \*\*\*, numri i kontratës \*\*\*, e datës 10 janar 2011. Cili ka qenë historiku i kontratave të furnizimit me ujë për pasurinë e sipërcituar, si dhe pagesat para datës 10 janar 2011 dhe pas datës 10 janar 2011?
  - ii. Për kontratën e furnizimit me energji elektrike me numër \*\*\*, datë 11 maj 2011. Cili ka qenë historiku i kontratave të furnizimit me energji elektrike për pasurinë e sipërcituar, si dhe pagesat e kryera para dhe pas datës 11 maj 2011?
  - iii. T’i kërkohet OSHEE-së dhe Ndërmarrjes së Ujësjetës aktet me të cilat janë regjistruar kontraktuesit pranë këtyre enteve.
  - iv. T’i kërkohet shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*” sh.p.k., nëse ka pasur kontrata të tjera të mëparshme për pasurinë e sipërcituar me subjektin, me babain e subjektit dhe me kontratën e shitjes me rezervë, të datës 30 korrik 2012, të lidhur ndërmjet babait të subjektit dhe shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.
  - v. T’i kërkohet Dhomës Kombëtare të Noterisë informacion dhe akte të saj, nëse ka, për kontrata të tjera të mëparshme të lidhura për këtë pasuri, nga i ati i subjektit të rivlerësimit, z. \*\*\*.\*\*, ose persona të tjerë të familjes, \*\*\*.\*\*, \*\*\*.\*\*, \*\*\*.\*\*, \*\*\*.\*\* dhe \*\*\*.\*\*.

1. Pranë institucionit të Komisionerëve Publikë është protokolluar shkresa e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2020, me anë të cilës është përcjellë shkresa e Trupit Gjykses, që i përket ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 86, datë 17.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Sikurse referohet në shkresë<sup>1</sup>, në seancën gjyqësore publike të datës 19.2.2020, trupi gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit vendosi çeljen e hetimit, për kërkim informacioni dhe dokumentacioni. Bashkëlidhur shkresës janë përcjellë dokumentacioni si vijon:

2. Dokument me datë \*\*\*.3.2020, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>2</sup>, nënshkruar nga administratori, z. \*\*\*.\*\*\*, me anë të së cilës bëhet me dije se kjo shoqëri ka qenë vetëm në rolin e shoqërisë së ndërtimit sipas lejes së miratuar nga Bashkia Tiranë, si dhe nuk disponon dokumentacion për kontratat apo aktet e shitjes për objektin, pasi janë kryer nga pala shitëse “\*\*\*\*”;

2.1 Komisioneri Publik vlerëson se përgjigjja e dhënë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. jep informacion të mjaftueshëm për drejtimin e hetimit të çelur.

3. Dokument, mungon data, me përshkrimin \*\*\*/2020, nga shoqëria “\*\*\*\*”,<sup>3</sup> nënshkruar nga administratori, z. \*\*\*.\*\*\*, ku informon se në lidhje me apartamentin në fjalë nuk ka kontrata të tjera të mëparshme të lidhura nga shoqëria me shtetasin \*\*\*.\*\*\* apo edhe me persona të tjerë përveç kontratës së datës 30.7.2012;

3.1 Komisioneri Publik vlerëson se përgjigjja e dhënë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dëshmon se për pasurinë në rrugën “\*\*\*\*.\*\*\*\*”, Tiranë, nuk ka kontrata të tjera të mëparshme të lidhura me shtetasin \*\*\*.\*\*\* apo me persona të tjerë, pra këto të dhëna i shërbejnë drejtimin të hetimit për marrëdhënien e \*\*\*.\*\*\* me pasurinë në fjalë, përse i përket aspektit kohor të marrëdhënies.

4. Shkresë me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.4.2020, e Ujësjes Kanalizime Tiranë sh.a., me anë të cilës konfirmohet fakti se Kontrata me nr.\*\*\* është aktivizuar në vitin 2010 dhe është bërë ndryshim emri në vitin 2012 nga “\*\*\*\*” sh.p.k., në emër të z. \*\*\*.\*\*\*. Nga kontrolli në arkiv nuk disponohet dokumentacion për ndryshimin e emrit. Bashkëlidhur janë dërguar 6 fletë të printuara nga Sistemi i Menaxhimit të Informacionit (SMI), ku pasqyrohen pagesat e kryera nga muaji dhjetor 2010 deri në muajin shkurt 2020;

4.1 Komisioneri Publik vlerëson se përgjigjja e dhënë nga Ujësjes Kanalizime Tiranë sh.a., për furnizimin me ujë, jep të dhëna për pagesat e kryera për kontratën respektive, të cilat mbulojnë periudhën para datës 11 janar 2011, sikurse ishte kërkesa për hetim nga Kolegji. Vlen të përmendim faktin se nga muaji janar 2011 deri në muajin gusht 2012, rezulton me konsum 0 (zero), duke kryer pagesa në vleftë konstante prej 340 lekë apo 540 lekë në muaj, që tregon se nuk ka patur konsum dhe përdorim të rrjetit të ujësjes-kanalizimeve.

5. Shkresë me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.4.2020, e Furnizuesit të Shërbimit Universal në OSHEE Group, me anë të së cilës dërgohet kopje të listpagesave për periudhën qershor 2011-

<sup>1</sup> Shkresa nr.\*\*\*2019, regjistër (JR), datë \*\*\*.6.2020.

<sup>2</sup> Protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2020.

<sup>3</sup> Protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.4.2020.

mars 2020, si dhe detaje të abonentit për kontratën me kod klienti: \*\*\*, në emër të z. \*\*\*,\*\*\*,

5.1 Komisioneri Publik vlerëson se përgjigja e dhënë nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për furnizimin me energji elektrike jep të dhëna për pagesat e kryera për kontratën respektive, të cilat mbulojnë periudhën pas muajit maj 2011. Vlen të përmendim faktin se nga muaji qershor 2011 deri në muajin gusht 2012, pagesa është në vleftë konstante prej 340 lekë në muaj, që tregon se nuk ka patur konsum të energjisë elektrike.

6. Pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë është protokolluar gjithashtu edhe shkresa e dërguar nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2020, me anë të së cilës është përcjellë shkresa e Trupit Gjykues, përsa i përket informacionit nga Dhoma Kombëtare e Noterisë me lëndën nëse disponohen akte apo kontrata që lidhen me këtë pasuri në emër të z. \*\*\*,\*\*\* apo familjarëve të tjerë. Në kthim-përgjigjen e Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe në vërtetimin e lëshuar nga notere znj. \*\*\*,\*\*\* vërtetohet që për subjektin z. \*\*\*,\*\*\* nuk janë nënshkruar kontrata të tjera të mëparshme pranë zyrës së noteres apo edhe me persona të tjerë të lidhur me z. \*\*\*,\*\*\*.

Nga të dhënat që përmbajnë dokumentet dhe shkresat e sipërcituara, vlerësimi i Komisionerit Publik është që ato kanë shteruar hetimin e çelur dhe tashmë Komisioneri Publik ka krijuar bindjen për kriterin e vlerësimit të pasurisë, i cili pa këtë hetim nuk do ishte i plotë, do të përmbante mangësi dhe, për rrjedhojë, në gjendjen që ishin aktet nuk mund të konkludohej nëse subjekti i rivlerësimit kishte arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 59, pika 1, germa “a”, e ligjit nr. 84/2016. Tashmë, pasi u njohëm me këto akte, Komisioneri Publik është i gatshëm të shprehet dhe për konkluzionet përfundimtare pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

**KOMISIONERI PUBLIK**  
**Darjel SINA**